



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.524/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hazbi Bajra, Sekretar i subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Hazbi Bajra, Sekretar i subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me numër ZL.Anr.524/2017 e datës 25.10.2017, e parashtuar kundër subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me postë me datë 25.10.2017 nga Hazbi Bajra, Sekretar i subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Istogut, nga radhët e subjektit politik AAK, Gani Dreshaj, më datë 22.10.2017 në ora 10:00 në afërsi të Qendrës së Votimit, në ditën e votimit ka bërë fushatë duke vendosur një billboard të afërsi prej 100 metrave. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është shkelur neni 7 pika a) e Rregullës Zgjedhore 11/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtuesit të ankesës Hazbi Bajra, Sekretar i subjekti politik LDK, dega në Istog, lidhur me shkeljen e pretenduar të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore nga

ana e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj, sepse nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet objekti mbrapa fotografisë se në ditën e votimit është duke u shfrytëzuar si qendra të votimit.

Me këtë rast paneli vlerësoi, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117.2 dhe 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr. 524/2017 me datë 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Gylfene Sylejmani**



***KëshillaJuridike:Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***